



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

K R Y E T A R I

Nr. 871/11 Prot.

Tiranë, më 31.12.2016

V E N D I M

Nr. 184, Datë 31.12.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT

TË USHTRUAR NË DREJTORINË E POLICISË SË SHTETIT

“MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË

FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

- I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, të ushtruar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Tiranë, për periudhën 01.01.2014 deri 30.8.2016.
- II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME/ PËRMIRËSIME LEGJISLACIONI.

1. Nga auditimi u konstatua se për vitet 2015 dhe 2016 janë kryer pagesa për kompensimin në vlerë të pushimeve të pakryera vjetore, të cilat në total arrijnë në shumën 7,928,669 lekë. Kryerja e pagesave për kompensimin financiar të pushimeve të pakryera vjetore është bazuar në përcaktimet e bëra në nenin 63, pika 4, të Ligjit nr. 108/2014, datë 37.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”, në të cilin përcaktohet që “Kur, për arsye pune e shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës, në të kundërt bëhet kompensimi në vlerë financiare”.

Pavarësisht faktit që në nenin 63, pika 6, të Ligjit nr. 108/2014, datë 37.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”, në të cilin përcaktohet që *“Rregullat dhe procedurat e përfitimit të pushimeve dhe trajtimit financiar të punonjësit të policisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”* nga auditimi rezultoi që nga Këshilli i Ministrave (për afro dy vjet nga miratimi i ligjit) ende nuk është nxjerrë asnjë VKM për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të përfitimit të pushimeve dhe trajtimit financiar të punonjësve të policisë.

Në zbatim të përcaktimeve ligjore të bëra në nenin 143, pika 4, të Ligjit nr. 108/2014, datë 37.07.2014 “Për Policinë e Shtetit” në të cilin përcaktohet që *“Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministri të nxjerrin të gjitha aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 6 muajve nga botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare”*, Këshilli i Ministrave duhet të kishte miratuar VKM përkatëse për trajtimin financiar të punonjësit të policisë gjatë qëndrimit në punë (në zbatim të nenit 67/1, germa (a) të Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”) dhe përcaktimin e funksioneve për gradë (në zbatim të nenit 61/1 të Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”) ndërsa Ministri i Punëve të Brendshme duhet të kishte miratuar Udhëzimin për administrimin e fondit të veçantë e të fondit të posaçëm (në zbatim të nenit 138/3 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”).

Nga ana tjetër, për punonjësit e policisë me status të Nëpunësit Civil apo dhe ata që trajtohen me Kod Pune, legjislacioni në fuqi nuk parashikon të njëjtin trajtim financiar si punonjësit e tjerë të policisë përsa i përket kompensimit financiar të pushimeve të pakryera vjetore.

Konkretisht, në Kreun II, pika 3, të VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në Institucionet shtetërore”, të ndryshuar përcaktohet që *“Pushimet vjetore nuk mund të kompensohen me pagesë, përveç rastit kur është zgjidhur marrëdhënia e punës. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, do të jetë e pavlefshme”*, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2011, përcaktohet që *“Nëpunësi/punonjësi i administratës publike gëzon të drejtën e kryerjes së pushimit vjetor të paguar. Nuk lejohet kompensimi financiar i pushimit vjetor të pakryer”*, ndërsa në nenin 94, pika 5, të Kodit të Punës, i ndryshuar përcaktohet që *“Pushimet vjetore nuk zëvendësohen me pagesë, me përjashtim të rasteve kur marrëdhënia e punës ka përfunduar dhe punëmarrësi nuk i ka kryer pushimet që i takojnë. Në këtë rast, ai ka të drejtë për një shpërblim të barabartë me pagën e këtyre pushimeve”*.

Duke pasur parasysh faktin që moskryerja e pushimeve vjetore nga ana e punonjësve të policisë së shtetit lidhet ngushtësisht me ngarkesën në punë të punonjësve të policisë dhe njëkohësisht çdo punë e punonjësve të policisë (të çdo niveli) lidhet ngushtësisht me misionin kryesor të Policisë së Shtetit që është ai i ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, Kontrolli i Lartë i Shtetit e konsideron si tepër të rëndësishëm mos diskriminimin financiar të çdo punonjësi policie pavarësisht nivelit, gradave, apo statusit të tij në strukturën organike të Policisë së Shtetit. Në këtë kuptim, çdo përcaktim ligjor apo nënligjor, i bërë në Ligjin nr. 108/2014, datë 37.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”, në legjislacionin për shërbimin civil apo në Kodin e Punës, duhet të ruajnë të njëjtat parime të trajtimit financiar të çdo punonjësi të policisë përsa i përket kompensimit financiar të lejeve të pakryera vjetore (*trajtuar në faqe 65-72 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Ministria e Punëve të Brendshme, të marrë masa për miratimin sa më parë në Këshillin e Ministrave të VKM-eve për trajtimin financiar të punonjësve të policisë gjatë qëndrimit në punë (në zbatim të nenit 67/1, germa (a) të Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”) dhe përcaktimin e funksioneve për gradë (në zbatim të nenit 61/1 të Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”) dhe njëkohësisht miratimin nga Ministri i Punëve të Brendshme të

Udhëzimit për administrimin e fondit të veçantë e të fondit të posaçëm (në zbatim të nenit 138/3 të Ligjit nr. 108/ 2014 “Për Policinë e Shtetit”).

Menjëherë

Ministria e Punëve të Brendshme, të marrë masat që në vlerësim të rolit të çdo punonjësi policie, pavarësisht nivelit, gradave, apo statusit të tyre në strukturën organike të Policisë së Shtetit, të propozojë ndryshimet përkatëse ligjore e nënligjore, jo vetëm në Ligjin nr. 108/2014, datë 37.07.2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij por edhe në legjislacionin për shërbimin civil dhe Kodin e Punës, me qëllimin e favorizimit financiar dhe trajtimit jodiskriminues të çdo punonjësi policie, jo vetëm përsa i përket kompensimit financiar për pushimet e pakryera vjetore, por edhe përsa i përket orëve të punës të kryera jashtë kohës normale të punës.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjatë auditimit të zbatimit të buxhetit dhe ndryshimeve gjatë vitit për shpenzimet e investimeve, rezultoi se këto shpenzime janë rritur në vlera të konsiderueshme, duke vënë në diskutim hartimin e Projekt Buxheteve Afatmesme të miratuara për këtë Institucion, kështu konstatohet se për vitin 2014 investimet me financim nga buxheti i shtetit janë shtuar për 463,041 mijë lekë kundrejt 527,000 mijë lekë që ishte plani fillestar, ose janë rritur duke reflektuar një rritje në masën 88% të programimit fillestar, ndërsa investimet me financim të huaj janë pakësuar për 273,004 mijë lekë ndaj planit fillestar, ose në masën 56.5% të tij. Deviacion akoma më të madh tregojnë të dhënat e vitit 2015, ku rezulton se investimet me financim nga buxheti i shtetit janë shtuar për shumën 716,985 mijë lekë kundrejt 500,000 mijë lekë që ishte plani fillestar, me një rritje në masën 143%, ndërsa investimet me financim të huaj janë pakësuar për 230,000 mijë lekë ndaj planit fillestar, ose në masën 50% të tij. Vetëm për 8/mujorin e vitit 2016, konstatohet se investimet me financim nga buxheti i shtetit janë shtuar për shumën 112,018 mijë lekë kundrejt 533,704 mijë lekë që ishte plani fillestar, ose janë rritur në masën 21% të tij, por theksojmë se shifrat nuk janë përfundimtare dhe ndryshimet do të vazhdojnë dhe në periudhën në vazhdim (*trajtuar në faqe 11-28 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Strukturat drejtuese të këtij institucioni të nxjerrin përgjegjësitë e këtyre ndryshimeve gjatë vitit, për të mos lejuar që ndryshimet e destinacionit të investimeve të rezultojnë në këto përmasa, pasi kjo praktikë vë në diskutim hartimin e Projekt Buxheteve Afatmesme dhe plotësimin e marrëveshjeve të bëra me donatorët e huaj.

Në vazhdimësi

2. Nga auditimi i realizimit të buxhetit për periudhën e auditimit u konstatua se gjatë vitit 2015 dhe 8/mujorit 2016 është përdorur Letër Kredi për likuidimin e kontraktorëve të ndryshëm për blerjet e realizuara (investime dhe shpenzime operative) për Drejtorinë e Policisë së Shtetit. Konstatuam se përdorimi i LC (letër kredi, apo fondit të ngurtësuar në një bankë të nivelit të dytë deri në realizimin e kontratës) në këtë institucion, është bërë pas miratimit paraprak të Ministrit të Financave, për njësinë e varësisë QFMT, ku në secilin rast Nëpunësi Autorizues i kësaj njësie ka nënshkruar “Normat për kredinë dokumentare” me përfaqësuesin e V.. B. PAGESA me L/C është bërë për “Blerje armatimi”, “Blerje pajisje speciale”, “Mirëmbajtje për sistemin AFIS ARSENAL”, gjithsej në shumën 78,965,593 lekë, si më poshtë:

- Me urdhër shpenzimi nr.276, datë 30.12.2015, në vlerë 21,153,600 lekë, është çelur Letër Credi për llogari të Operatorit Ekonomik “A.. S..” shpk me seli në Tiranë për blerje armatimi, referuar kontratës së lidhur më datë 29.07.2015 dhe të amenduar më 30.12.2015, ku parashikohet lëvrimi i mallrave brenda dy muajve. Gjithashtu me këtë urdhër shpenzimi është bërë likuidimi i komisioneve të letër kredisë, në vlerë 126,922 lekë.
- Me urdhër shpenzimi nr.277, datë 31.12.2015, në vlerë 16,041,289 lekë, është çelur Letër Credi për llogari të Operatorit Ekonomik “C..” sha, Kosovë, për blerje “Aparat Video spektral VCS 800 me aksesore”, referuar kontratës së lidhur më datë 30.12.2015, ku parashikohet lëvrimi i mallrave jo më vonë se 95 ditë. Gjithashtu me këtë urdhër shpenzimi është bërë likuidimi i komisioneve të letër kredisë, në vlerë 96,246 lekë.
- Me urdhër shpenzimi nr.278, datë 31.12.2015, në vlerë 33,018,744 lekë, është çelur Letër Credi për llogari të Operatorit Ekonomik “E.. R..” Francë, për blerje “Dron”, referuar kontratës së lidhur më datë 31.12.2015. Gjithashtu me këtë urdhër shpenzimi është bërë likuidimi i komisioneve të letër kredisë, në vlerë 198,112 lekë.
- Me urdhër shpenzimi nr.182, datë 27.09.2016, në vlerë 8,751,9604 lekë, është çelur Letër Credi për llogari të Operatorit Ekonomik “P.. A..”, Rusi, me objekt “Mirëmbajtje për sistemin A A” referuar kontratës së lidhur më datë 28.06.2016. Gjithashtu, me këtë urdhër shpenzimi është bërë likuidimi i komisioneve të letër kredisë, në vlerë 53,892 lekë. Pra, është bërë likuidimi i komisioneve të letër kredisë në shumën 475,172 lekë.
- Nisur nga sa cituam, konstatohet deklarimi i investimeve/shpenzimeve të pa kryera si të realizuara, fakt që cenon rëndë parimin kryesor të realizimit të buxhetit atë të anualitetit (trajtuar në faqe 11-28 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandoj:

Të eliminohen praktika të tilla në realizimin e shpenzimeve buxhetore, sidomos në fund të vitit. Në raste të veçanta (të përcaktuara qartësisht me akte normative), të ketë formate ku specifikohen qartë kushtet e përdorimit të LC, në veçanti për masën e komisioneve dhe mënyrën e pagesës së tyre, pasi të sigurohet dakordësia me Ministrinë e Financave. Kjo praktikë të përdoret jo si mekanizëm për të deklaruar investimet si të realizuara por si instrument bankar.

Rekomandojmë me forcë që në këtë proces të përcaktimit të marrëveshjeve dhe kushteve të tyre, të sigurohet që strukturat drejtuese të Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave dhe domosdoshmërisht me Bankën e Shqipërisë.

Menjëherë

3. Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se, vlera e armatimit që përdor Policia e Shtetit, blerë me fonde buxhetore apo donacione, nuk pasqyrohet në evidencën kontabile të njësisë, ndërsa për evidentimin në sasi të armatimit në institucion gjatë vitit 2014 është ndërtuar sistemi SIMA, i cili mbahet nga Sektori i Armatimit, ku janë pasqyruar armatimet në sasi dhe përdoruesit e tyre, por edhe armatimi që disponohet nga subjektet tregtare private. Mbajtja në këtë mënyrë e armatimit është trashëguar ndër vite, duke ju referuar Rregullores së shërbimit të armatim-municionit të vitit 1990, ku regjistrimi dhe mbajtja e armatim-municionit ka qenë e klasifikuar sekret. Gjithashtu rezulton se, armatimi i vjetër mbahet vetëm në sasi pa vlerën përkatëse, duke bërë që të mos kemi një vlerë reale të armatimit në administrim të Policisë së Shtetit, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”,

Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.26, datë 28.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*trajtuar në faqe 28-38 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa që të pasqyrohet në evidencën kontabile vlera e armatimit, sipas çmimit së blerjes, apo dhe referuar çmimeve të tregut për armatimin e trashëguar në vite apo të dhuruar, konform rregullave kontabile dhe ato të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

4. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2014 dhe 2015 konstatohet se, ka rritje të konsiderueshme të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, ku llogaria 210 “Toka, troje dhe terrene”, në fund të vitit 2015 pasqyrohet me një rritje prej 3,925,870 mijë lekë krahasuar me vitin 2013, pasi nga njësitë shpenzuese është bërë vlerësimi i tokës, trojeve dhe terreneve dhe regjistrimi në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veprim që jep një pamje më të plotë të pasqyrave financiare dhe duke shtuar ndjeshëm pasurinë institucionit. Strukturat e Policisë së Shtetit disponojnë një sipërfaqe truall për 1,574,891 m², nga e cila është bërë vlerësimi sipas VKM nr.514, datë 30.07.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, vetëm për 1,289,258 m², *ndërsa diferenca prej 285,633 m² nuk është vlerësuar*, pasi dy njësi, Drejtoria Rajonale e Policisë Qarkut Korçë Drejtoria Rajonale e KM Gjirokastrë nuk kanë bërë vlerësimin e truallit.

Konstatohet se për të gjitha objektet ndërtimore të vjetra nuk është bërë vlerësimi sipas çmimeve të tregut, çka do të thotë se pasqyrat financiare të paraqitura nga njësitë shpenzuese në varësi të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, nuk pasqyrojnë vlerën reale për një pjesë të konsiderueshme të objekteve ndërtimore.

Nga procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit, por dhe nga Struktura e Auditit të Brendshëm në auditimet e kryera në njësitë e varësisë, janë konstatuar objekte ndërtimore të dëmtuara, objekte të cilat ekzistojnë në inventarë por jo fizikisht, objekte të cilat nuk përdoren nga strukturat policore, objekte të cilat banohen nga ish punonjës policie. Këto objekte janë të ekspozuara nga dëmtimi i mëtejshëm, humbja e identitetit dhe përdorimi i paautorizuar, fenomen pothuaj se në të gjitha njësitë. Konstatohet se aktivet e dëmtuara, ku përfshihen ndërtesa, mjetet transporti, inventar ekonomik, instalime pajisje e vegla pune, pasqyrohen në bilancin e vitit 2015 në shumën 575,282 mijë lekë nga 165,629 mijë lekë që ishte në fund të vitit 2014, vlerë e cila rrit në mënyrë të gabuar vlerën e aktiveve të institucionit (*trajtuar në faqe 28-38 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, së bashku me njësitë e varësisë, të marrë masa për vlerësimin e truallit për sipërfaqen 285,633 m² sipas kërkesave të VKM nr.514, datë 30.07.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, regjistrimin në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe pasqyrimin e kësaj vlere në evidencën kontabile.

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, së bashku me njësitë e varësisë, të merren masa për evidentimin e saktë të objekteve të dëmtuara dhe problematikat për to, si dhe të kryhen procedurat e tjetërsimit të tyre konform Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 226, datë 08.05.2015 i “Për përcaktimin e

përgjegjësi në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, vlerësimin, nxjerrjes nga përdorimi dhe kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësi shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme”.

Në vazhdimësi

5. Nga auditimi konstatohet se kjo njësi, por dhe nga i gjithë sistemi i policisë kontabiliteti është mbajtur manualisht dhe pjesërisht në programin “excel”, pra nuk përdoren programe të mirëfillta financiare, çka mund të rrisë riskun e gabimeve dhe pamundësisë për të gjeneruar në kohë të dhëna për të ndihmuar menaxherët në vendimmarrjen e tyre për menaxhimin e burimeve financiare (*trajtuar në faqe 28-38 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa për informatizimin e shërbimeve financiare me qëllim eliminimin e riskut të gabimeve, gjenerimit në kohë reale i të dhënave financiare për menaxherët e lartë dhe përdoruesit e pasqyrave financiare, por dhe në koherencë me shërbimet e tjera të këtij institucioni të cilat janë të informatizuara.

Menjëherë

6. Nga auditimi i pasqyrave financiare rezulton se, llogaria 429 “*Personeli, debitorë*” më 31.12.2015, pasqyrohet me një vlerë prej 307,416 mijë lekë. Në këtë llogari janë të evidentuar të gjithë debitorët e krijuar që nga viti 1997 e në vazhdim, dalë si rezultat i auditimeve dhe kontrolleve të ushtruara nga Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Sektori i Auditimit në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, KLSH-ja si dhe kontrollet e ushtruara nga drejtoritë e tjera në Policinë e Shtetit dhe nga vetë njësitë shpenzuese. Nga Drejtoria e Financave është hartuar database për të gjithë debitorët e krijuar ndër vite sipas njësi publike në varësi të Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Është bërë një ndarje e debitorëve sipas periudhave të krijimit, duke evidentuar debitorët me pamundësi arkëtimi. Sipas të gjitha informacioneve të ardhura nga njësitë publike në varësi të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, rreth 72% e debitorëve të krijuar, ose në shumë absolute 220,378 mijë lekë janë pa shpresë arkëtimi (*trajtuar në faqe 28-38 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, së bashku me njësitë e varësisë, në bashkëpunim me Ministrinë së Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Financave të merren masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite dhe të krijuar rishtazi. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të riverifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit dhe vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave për “Debitorët pa shpresë arkëtimi”, të bëjë parashkrimin e tyre dhe sistemimin në kontabilitet.

Në vazhdimësi

7. Nga auditimi i pasqyrave financiarë rezulton se, në llogaritë financiare “Stoku i letrave me vlerë të vendosjes” pasqyrohet vlera 577 mijë lekë, që përbën gjendjen e letrave me vlerë, konkretisht blloqe gjobash të rendit, të cilat kanë dalë nga qarkullimi e nuk përdoren nga kjo strukturë (*trajtuar në faqe 28-38 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Financës, me qëllim uljen e stokut të inventarit, të merren masa për tjetërsimin e këtyre blloqeve dhe sistemimi në evidencën kontabile, konform kërkesave kontabile dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.11.2011.

Menjëherë

8. Nga auditimi mbi strukturën dhe vlerësimi i sistemeve të pagave, konstatohet se, struktura është hartuar jo në përputhje me kërkesat e ligjit organik të Policisë së Shtetit, pasi për pozicione apo funksione pune janë përcaktuar dy grada. Në nenin 61 të ligjit “Përcaktimi i funksioneve për gradë”, në pikën 2 thuhet: “Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese”, pra për një funksion nuk mund të ketë dy grada.

Konstatohet se, edhe pse ligji ka hyrë në fuqi që në muajin mars 2015, akoma nuk ka dalë VKM përkatëse për miratimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, çka do të rregullonte edhe problematikën e trajtimit të plotë të punonjësve me vjetërsinë në punë, e cila deri më tani është e pazgjidhur dhe me efekte negative për këta punonjës. Miratimi i funksioneve korresponduese për çdo gradë është kërkesë e pikës 1 të nenit 61 të ligjit, ku shprehet: “tabela e funksioneve korresponduese për çdo gradë dhe kategorizimi i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Me implementimin e strukturës së re konstatohet se, për Aparatin e Drejtorisë së Policisë, përfshirë dhe Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin dhe atë të Krimin të Organizuar si njësi buxhetore më vete, ka pozicione apo funksione që mbahen nga punonjës me gradë më të ulët, por dhe pozicione që mbahen nga punonjës policie me gradë më të lartë (për të dy rastet ndryshimi është deri në dy grada. Trajtuar në faqe 58-71 të Raportit të Auditimit)).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa për plotësimin e funksioneve me gradën korresponduese, detyrim që buron nga neni 61 i ligjit, çka do të rregullonte edhe problematikën e trajtimit të plotë të punonjësve me vjetërsinë në punë, e cila deri më tani është e pazgjidhur.

Menjëherë

9. Nga auditimi rezultoi që në strukturën e Drejtorisë së Policisë së Shtetit përveç njësive buxhetore të Aparatit ekzistojnë edhe dy njësi të tjera buxhetore të të njëjtës natyrë, përkatësisht në Drejtorinë e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda dhe në Drejtorinë e Përgjithshme për Kufirin dhe Emigracionin.

Në kushtet kur funksionet dhe detyrat e këtyre njësive buxhetore janë të njëjta për nga natyra shtrohet si domosdoshmëri eliminimi i çdo funksioni të dubluar dhe paralel me qëllimin e mirëmenaxhimit dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike (trajtuar në faqe 65-72 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa për rishikimin e strukturës së Policisë së Shtetit me qëllim eliminimin e strukturave apo pozicioneve paralele të njësive buxhetore.

Menjëherë

10. Nga auditimi mbi strukturën dhe organikën e Policisë së Shtetit konstatohet se, deri në momentin e auditimit për 69 punonjës aktualë, të cilët referuar strukturës së miratuar kanë status “nëpunës civil”, *për të cilët nuk janë zhvilluar procedura konkurrimi dhe nuk është marrë konfirmimi nga Departamenti i Administratës Publike, e për rrjedhojë këta punonjës akoma nuk janë përfshirë në regjistrin e këtij të fundit, nuk ka gjetur zbatim neni 39 “Statusi i punonjësve të policisë”, i ligjit nr.108/2014, datë 37.07.2014 “Për Policinë e Shtetit” ku përcaktohet se: “punonjësi i policisë është nëpunës civil, ndaj të cilit zbatohen dispozitat e*

ligjit për nëpunësin civil, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm” (trajtuar në faqe 58-71 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa për realizimin e procedurave konkurruese në punësimin e punonjësve të cilët trajtohen me statusin “nëpunës civil” dhe eliminimin e praktikave të punësimit me argumentin: “...për nevoja të ngutshme pune, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit të punonjësit në këto funksione nga DAP...”.

Menjëherë

11. Në rregulloren e brendshme të institucionit, njësia ka miratuar përkrahimin e punës për çdo pozicion pune në institucion, apo procedurat standarde për të gjitha drejtoritë të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm që në vitin 2009, ku përfshihen detyrat që duhen kryer nga çdo strukturë por, me daljen e ligjit të ri të policisë së shtetit dhe miratimin e rregullores përkrahimet e punës nuk i janë nënshtruar rishikimeve dhe miratimeve për tu përshtatur me kërkesat e ligjit të ri, i cili duhet thënë se ka hyrë në fuqi që në muajin mars 2015 (trajtuar në faqe 58-71 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa për miratimin nga Drejtori i Përgjithshëm të Procedurave Standarde për të gjitha drejtoritë, konform kërkesave të ligjit të Policisë së Shtetit dhe të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ku të përcaktohet qartë përkrahimi i punës për çdo pozicion.

Menjëherë

12. Nga auditimi për periudhën 01.01.2014 deri më 31.08.2016, konstatohet se për lëvizjet e personelit, si emërimet, largime apo lëvizje paralele nuk është hartuar në kohë dokumentacioni dhe për rrjedhojë nuk është bërë deklarimi i punonjësve në organet tatimore konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.23, datë 19.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për Mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si pasojë e deklarimeve me vonesë të punonjësve, në sistemin tatimor ndaj Drejtorisë së Policisë (Aparatit të Drejtorisë) *aktualisht rezultojnë gjoha në shumën 780 mijë lekë (trajtuar në faqe 58-71 të Raportit të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës të merren masa për deklarimin në kohë të lëvizjeve të punonjësve pranë organeve tatimore; konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.23, datë 19.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar.

Menjëherë

13. Nga auditimi rezulton se, në vitet 2014 dhe 2015, si dhe 8/mujori i vitit 2016 janë kryer shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna të punonjësve të

Policisë së Shtetit, gjithsej në 529 raste, në shumën 338,072 mijë lekë (nga fondet e çelura për borxhin për 139,009 mijë lekë dhe nga fondet e veta 199,064 mijë lekë), si detyrime të lindura e të trashëguara para vitit 2014, por dhe gjatë periudhës së auditimit, kryesisht për largime nga puna të punonjësve të Policisë së Shtetit por dhe për detyrime kontraktore. Këto detyrime do të rriten dhe gjatë vitit aktual, kjo jo vetën se gjatë ushtrimit të auditimit janë paguar e janë në proces edhe rreth 37 milion lekë detyrime, por janë procese të tjera gjyqësore për të cilët akoma nuk ë dalë vendimi i gjykatës.

Kryerja e këtyre shpenzimeve, për detyrimin ndaj punonjësve dhe subjekteve të tjera në shumën 338,072 mijë lekë dhe e shpenzimeve përmbarimore në shumën 18,645 mijë lekë, përbëjnë përdorim pa efektivitet dhe efincë të fondeve buxhetore dhe që kanë rënduar padrejtësisht buxhetin e institucionit dhe atë të shtetit, pasi referuar një pjese të vendimeve gjyqësore, urdhrat për largimet e punonjësve nga puna janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore (trajtuar në faqe 115-119 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, së bashku me njësitë e varësisë, të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësisë për nxjerrjen e urdhrave për largimet e punonjësve nga puna në kundërshtim me dispozitat ligjore pambështetura, si dhe eliminimin e këtyre praktikave të largimit të punonjësve.

Institucioni, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të kryejë likuidimin me paraqitjen e kërkesës, pa u dashur ndërhyrja e Shërbimit Përmbarimor me qëllim eliminimin e shpenzimeve përmbarimore.

Menjëherë

14. Gjatë auditimit të procedurës së tenderit “Sistemi multifunksional i kamerave ..”, u konstatua se procedura ishte e klasifikuar “sekret” në nivel sigurie “I kufizuar”, në zbatim të urdhrat të Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 459, datë 26.8.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 341, datë 1.10.2010 “Për listën e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror” në MPB i ndryshuar. Në këtë udhëzim dokument i klasifikuar është përcaktuar ai me numër rendor 26, me emërtim “**Materiali filmik (Audio/video)**”.

Në këtë praktikë vërehet standard i dyfishtë në trajtimin e personave/subjekteve që operojnë me procedura prokurimi “të klasifikuara”. Për Operatorët Ekonomik të cilët fitojnë kontrata pune, të klasifikuara “sekret” në nivel sigurie “I kufizuar”, AK lejon të punohet, pa qenë e nevojshme që të pajisen me “Certifikatë sigurie”, por vetëm duke u “brifuar” (udhëzuar) personat që do të kryejnë punimet për nivelin e sigurisë, ndërkohë që audituesve për të audituar dokumentacionin, ju është kërkuar të jenë pajisur me “certifikatë sigurie” nga DSIK, proces që shoqërohet me pengesa/vonesa deri në mos auditim të këtyre procedurave prokurimi.

Nisur nga emërtimi i përdorur për këtë procedurë, për shkak se “**Materiali filmik (Audio/video)** është produkt që realizohet pas përfundimit të procedurës së tenderit, gjykojmë të gabuar zgjedhjen e kësaj procedure nga AK, dhe si një artificë për të anashkaluar gjurmën audituese.

Veç këtij elementi konstatuar në tenderin “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit”, në tenderë të tjerë, të periudhave të mëparshme, shkak i “Klasifikimit” të dosjes në tërësi, ka qenë “vendi” ku kryheshin punimet e ndërtimit, dhe pavarësisht se materialet e dosjes, nuk kanë pasur lidhje me vendin ku janë kryer punimet, dosja nuk mund të auditohej, pasi është e klasifikuar “sekret” (trajtuar në faqe 96-110 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandoj:

Dosjet e tenderëve të klasifikuar “sekret” në nivele të ndryshëm sigurie, përmbajtja/materiali i të cilave nuk bie ndesh me kriterin specifik që ka bërë klasifikimin e tyre “sekret”, të mos arkivohen si të tilla, por t’i nënshtrohet parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 të ndryshuar, pra të jenë e aksesueshme në çdo kohë nga personat e autorizuar për këtë qëllim. Në tenderët të cilët janë të klasifikuar “sekret” në nivel sigurie “I kufizuar” AK, me të njëjtat arsye që lejon operatorët ekonomikë të zbatojnë kontratën për punë, mallra, shërbime pa “certifikatë sigurie”, të lejohen edhe Institucionet apo subjektet e njohur ligjërisht për auditim.

Menjëherë

15. Gjatë periudhës objekt auditimi janë zhvilluar 43 prokurime me procedurë “Me negociim pa shpallje paraprake ...” gjithsej, me fond limit 848,741 mijë lekë dhe realizuar 837,567 mijë lekë. U audituan 10 prej tyre, nga të cilat rezultoi se procedura zgjedhur nga AK ka **qenë e gabuar në tre prej tyre, me fond limit 654,912 mijë lekë, ose mbi 78 për qind e tyre**, në tenderët me objekt si poshtë:

- “*Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit*” loti I, procedurë prokurimi e klasifikuar në nivelin e sigurisë “I kufizuar, i zhvilluar në vitin 2015 me fitues BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. me fond limit 450,012,324 lekë.
- “*Uniforma për Policinë e Shtetit*” me vlerë 198,000 mijë lekë, i zhvilluar në vitin 2015, i fituar nga BOE “Gj..” sh.p.k. dhe “D..” sh.p.k.
- “*Blerje qese dhe arka për administrimin e provave*” me vlerë të plotë 8,341 mijë lekë, i zhvilluar në vitin 2015.

Për të tre tenderët, zhvillimi i procedurës “Me negociim pa shpallje paraprake” është në kundërshtim me nenin 33 të ligjit datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pasi autoriteti kontraktor, nuk gjendet në asnjë nga situatat e përcaktuara me këto dispozita. Normalisht AK duhet të zhvillonte procedurë prokurimi “Të hapur” (*trajtuar në faqe 111-117 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

AK të marrë masat e nevojshme për evidentimin në kohë të nevojave për punë, mallra e shërbime, me qëllim zhvillimin normal të procedurës të tenderimit “Të hapur”, për të eliminuar plotësisht krijimin e situatave artificiale “emergjente”, të cilat çojnë në uljen e konkurrencës, diskriminimin e OE etj.

Në vazhdimësi

16. Për periudhën objekt auditimi janë kryer shpenzime të konsiderueshme për udhëtime jashtë shtetit dhe kryesisht për ekstradimet e shtetasve nga vendet e tjera, kështu për vitin 2014 janë shpenzuar 42,774 mijë lekë, për vitin 2015, janë shpenzuar 26,405 mijë lekë dhe 8/mujorin e vitit 2016 është shpenzuar vlera 27,988 mijë lekë, ku pjesën më të madhe në këto shpenzime e zënë blerjet e biletave të udhëtimit për jashtë shtetit. Konstatohet se, blerja e biletave të udhëtimit është bërë drejtpërdrejt në operatorët ekonomikë nga vetë punonjësit, pa u zhvilluar procedura prokurimi, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e dispozitave ligjore për prokurimet, VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, shfuqizuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshime.

Nga auditimi konstatohet se për udhëtime jashtë shtetit janë likuiduar operatorët ekonomikë, por urdhrat e titullarit kanë dalë pas kryerjes së shërbimit, si dhe faturat janë lëshuar pas kryerjes së tij, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.870, date 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe Udhëzimin e Ministrisë

së Financave nr. 22, datë 10.07.2012 “Mbi zbatimin e vendimit nr.870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë shtetit”, si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*trajtuar në faqe 115-119 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa për zhvillimin e procedurave të prokurimit për shërbimet me jashtë shtetit, konform kërkesave të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshime, si dhe për nxjerrjen në kohë të urdhrave të Titullarit për këto shërbime.

Menjëherë

17. Nga auditimi për vlerësimin e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm u konstatua se, auditimi i njërive të varësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë realizohet edhe nga Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Punëve të Brendshëm. Ndërkohë për rezultatet e auditimeve të kryera në këto njësi varësie, nuk informohen drejtuesit e Policisë së Shtetit, pra për nivelin e gjetjeve, vlerësimin e riskut dhe performancës së tyre. Kjo mënyrë e të vepruarit të kësaj strukture të MPB ka sjellë që hartimi i programit strategjik dhe vjetor i Sektorit të Auditimit në DPP-së të jetë i pjesshëm dhe pa reflekuar të gjitha risqet e evidentura nga auditimi i brendshëm (*trajtuar në faqe 45-58 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa që në të ardhmen të rrisë nivelin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MPB, me qëllim hartimin e një plani strategjik dhe vjetor real, shkëmbimit të informacionit mbi gjetjet nga auditimi, me qëllim shmangien e planifikimeve të dubluara, si dhe krijimin e një dosje të përhershme auditimi në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Menjëherë

18. Sektori i Auditimit të brendshëm për vitin 2014, 2015 dhe 8-mujorin e vitit 2016, ka kryer auditime mbi bazë sistemi, kryesisht për sistemin e proceseve organizative, sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit, sistemin e pagesave, sistemin e prokurimeve, sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar, sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore, si dhe sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të njësisë por, nuk ka trajtuar plotësisht funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Nga kjo strukturë janë trajtuar elementë të veçantë të sistemit gjatë auditimeve të kryera në njësitë e varësisë. Nga verifikimi i dosjeve të auditimit të brendshëm, u konstatua se pas evadimit të materialeve të auditimit apo, të mbarimit të shërbimit operativ, dosjet e auditimit janë të inventarizuara, por të pa arkivuara, në kundërshtim me nenin 15, 30 të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” (*trajtuar në faqe 45-58 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Sektori i Auditimit të Brendshëm të merren masa që në të ardhmen në programet e auditimit të përcaktojë dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponentëve si, mjedisi i kontrollit, menaxhimit i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni dhe komunikimi dhe monitorimi

Nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, të merren masa për krijimin e ambienteve të përshtatshme për arkivin e dokumenteve. Dosjet e auditimit të plotësohen me dokumentacionin përkatës, të inventarizohen dhe të arkivohen në përputhje me dispozitat ligjore për arkivat.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Dëmi ekonomik i shkaktuar është **207,807,109 lekë** gjithsej, nga i cili:

C.I DËM EKONOMIK I ARKËTUESHËM

Nga auditimi rezultoi që dëmi ekonomik i arkëtueshëm përlllogaritet në **18,807,109 lekë** për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

1. OE “C..” sh.p.k. me administrator z. S.B në vlerën **16,500,000 lekë**, pasi në preventivin/situacionin e paraqitur prej tij, për tenderin me objekt *“Studim projektim i objekteve të Policisë së Shtetit”* me fond limit 28,140,957 lekë, i zhvilluar në vitin 2016, u konstatuan përsëritje të zërave/punëve të kryera në vlerën 16,500,000 lekë (e njëjta punë e paguar dy herë) (trajtuar në faqe 92-94 të Raportit të Auditimit).

2. BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k vlerën **1,990,400 lekë**, pasi në tenderin me objekt *“Sistemi multifunksional i kamerave të trupit ...”* me fond limit 450,012,324 lekë, ka pranuar/ndryshuar zërat me numër 13 dhe 14 të paragrafit IV *“Rrjeti i komunikimit aktiv”* duke negociuar për sasi/volumet në ulje, dhe çmimet në rritje. Praktika normale pranon si objekt të negociimit uljen e çmimit të sasive/volumeve të preventivuara dhe jo ulja e sasive të parashikuara në preventiv, pasi sasi/volumet janë të pa negociueshme. Sasi apo volumet e mallrave janë hartuar/miratur nga grupet përkatëse dhe janë pjesë e DST, të hedhur në tender me të cilat OE janë njohur, i kanë pranuar dhe kanë paraqitur ofertën përkatëse.

Po kështu, pas përcaktimit të ofertës/operatorit ekonomik fitues, objekt negociimi, nuk është rritja e çmimit, por ulja e tij. Në këto kushte vlerësojmë që KVO ë vepruar në kundërshtim me nenin 58 *“Komisioni i vlerësimit të ofertave”* të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.* Sasi e ndryshuara në ulje, cilat nuk janë reflektuar në fondin limit, janë 10,400 ml kablllo të llojeve të ndryshme me vlerë 1,990,000 lekë gjithsej (trajtuar në faqe 83-89 të Raportit të Auditimit).

3. Komisionit të vlerësimit të ofertave të përbërë z. E.D, E.K dhe S.H për **277,000 lekë**, ose nga 92,333 lekë/secili, pasi në tenderin me objekt *“Blerje pajisje kriminalistike”* loti i II me fond limit 5,577,660 lekë, i zhvilluar në vitin 2015, për parregullsi të njëjta ka mbajtur standard të dyfishtë në kualifikimin e OE. Ka skualifikuar padrejtësisht OE “P..” sh.p.k. me ofertë 4,958 mijë lekë, ose 277 mijë lekë pak se sa OE “F..” sh.p.k. i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues (trajtuar në faqe 80-83 të Raportit të Auditimit).

4. Drejtoria e Policisë së Shtetit të nxjerrë përgjegjësitë dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **39,709 lekë** nga personat shkaktarë, pasi i janë likuiduar shpenzime gjyqësore Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, më shumë se sa tarifa e përcaktuar për kërkesë padinë. Sipas faturës për arkëtim të kësaj gjykate vlera e shërbimit është 44,350 lekë, kurse referuar tarifës 1 për qind për kërkesë padinë për arkëtimin e detyrimit 444,410 lekë nga

personat përgjegjës, detyrimi në fakt është 4,441 lekë, që së bashku me shërbimin e njoftimit prej 200 lekë arrin në shumën 4,641 lekë.

C.II EFEKT FINANCIAR NEGATIV PA MUNDËSI RIKUPERIMI

Në procedurën e tenderit me objekt “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit” (loti parë) me vlerë të plotë 540,533,139 lekë zhvilluar gjatë vitit 2015, janë konstatuar problematika të shoqëruara me efekte negative financiare për Buxhetin e Shtetit të cilat në gjykimin tonë arrijnë minimalisht në nivelin 189,000 mijë lekë. Ky efekt negativ rezulton në përllogaritjen e fondit limit, nga krahasimi i çmimeve të ofruar nga operatorët ekonomikë vendas dhe të çmimeve të ofruar/kombinuar nga operatorët ekonomikë vendas me çmimet ndërkombëtarë të publikuar.

Procedura e projektit të “Sistemi multifunksional i kamerave ...” ka nisur me aplikimin e pare nga DPSH, 26.02.2015 me vlerë të plotë të projektit 838,005,339 lekë, e cila në aplikimin e dytë është bërë 585,133,779 lekë dhe me VKM Nr. 21, datë 16.3.2015 “Për shpërndarjen e fondit për programin “Shqipëria digjitale” në tabelën nr. 1 me emërtim “Projektet për financim për programin Shqipëria Dixhitale, me numër rendor 2, për AK “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”, ka përfunduar me vlerën e plotë të projektit 540,533,139 lekë.

Konstatuam se për këtë vlerë AK (grupi i punës), **nuk ka dokumentuar referencat** që kanë shërbyer për llogaritjen e vlerës së plotë të projektit (përfshirë fondin limit), shkaqet e ndryshimit, nga vlera 838,005,339 lekë, deri në vlerën përfundimtare të projektit prej 540,533,139 (nga e cila *fondi limit* 450,444,282 lekë), në **kundërshtim** me nenin 59/2 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, dhe specifikisht me kërkesat/kriteret e përcaktuara për aplikim me projekte në Komitetin e zhvillimit të Rajoneve (KZHR) ku ndër të tjera ka qenë kusht dhe paraqitja e “Dokumenteve teknike” për projektin:

- *Projekti teknik,*
- *Preventivi, argumentimi teknik,*
- *Përllogaritja e kostove të mirëmbajtjes së investimi.*

AK pasi ka marrë fondin limit (VKM nr.21, datë 16.3.2015), rreth katër muaj më vonë ka vijuar procedurën e prokurimit pikërisht me llogaritjen, argumentimin e “fondit limit”, për të cilën është shprehur se ... *me fondin limit në shumën 540,533,139 lekë sipas VKM nr. 21, datë 16.3.2015, për zbatimin e projektit “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit...”*. Kjo llogaritje e fondit limit, nuk ka kuptim. Ai është llogaritur nga AK dhe është miratuar kohë më parë, me VKM.

Pavarësisht sa më sipër, u auditua procedura e llogaritjes së fondit limit ashtu si është bërë, dhe u konstatua se AK në përllogaritjen e vlerës së plotë të projektit (përfshirë fondin limit) është ... *Bazuar në testimin e tregut (vendas) dhe ka kërkuar oferta nga OE që operojnë në këtë fushë.*

OE që kanë pranuar kryerjen e shërbimit dhe që kanë paraqitur ofertë ekonomike për realizimin e tij janë:

- S.. sh.p.k. me ofertë pa TVSH 450,971,450 lekë datë 3 gusht 2015
- C.. sh.p.k. ... 450,012,324 “ datë 3 gusht 2015
- S .&. sh.p.k.450,276,760 “ datë 3 gusht 2015

Në vijim komisioni (grupi i punës) është shprehur se ... për blerjen e këtyre pajisjeve, në argumentimin e fondit limit u bazuam në ofertën më të ulët (të OE C.. sh.p.k.).

Konstatohet se **“Rastësisht”** oferta/fondi limit i ofruar nga OE në muajin gusht 2015, përputhet me vlerën (fondin limit) të miratuar me VKM Nr. 21, datë 16.3.2015.

Në vijim të procedurës, AK (njësia e prokurimit) ka dërguar/kërkuar “Ftesë për ofertë” 5 OE:

- S.. sh.p.k.
- A.. sh.p.k
- P.. S.. sh.p.k.
- S. & .. sh.p.k.
- C.. sh.p.k.

Duke ju referuar përgjigjeve që kanë dhënë pesë OE (tre prej të cilëve kanë dhënë oferta për llogaritjen e fondit limit), Autoritetit kontraktor, për “Ftesë për ofertë” konstatohet se OE:

- S.. sh.p.k. është shprehur se ... pasi kishte vlerësuar dhe analizuar me kujdes DST, nuk mund të paraqiste një ofertë të plotë dhe të vlefshme (PV i KVO nr. 3 datë 12.10.2015).
- A.. sh.p.k. është shprehur se ...për arsye objektive nuk mund të paraqiste një ofertë të vlefshme për këtë tender (PV i KVO nr. 4 datë 12.10.2015)..
- P.. S.. sh.p.k. është shprehur se ... duke parë specifikën e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara, nuk mund të paraqesë një ofertë për këtë prokurim (PV i KVO nr. 5, datë 12.10.2015).
- S. & .. sh.p.k. ka paraqitur dokumentacion për pjesëmarrje në tender, por është skualifikuar nga KVO për disa parregullsi në dokumentacionin ligjor, kualifikues.

OE “C..” sh.p.k. është paraqitur jo i vetëm, por si BOE midis “C..” sh.p.k. dhe “T.. s” sh.p.k., i cili është pranuar në heshtje nga AK. Sa më sipër, komprometon dhe ofertën e OE “C..” sh.p.k. në llogaritjen e fondit limit (ofertuesi i tretë). **Realisht tenderi rezulton të jetë kryer mbi bazën e një oferte.**

Sa më sipër, është në **kundërshtim** me nenin 59/2 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ... Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet **t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë si çmimet e tregut, kontrata të mëparshme dhe/ose “çmime ndërkombëtare të botuara”**.

Është një projekt me vlerë rreth 4,5 milion euro. Mbështetur në DST e hartuara/miratuara nga AK, **qëllimi i prokurimit, është marrja e “Çmimi më i ulët”**. Për të realizuar këtë, grupi i punës për llogaritjen e fondit limit, normalisht duhet **t’i referohej një ose më shumë alternativave** të mundshme për të realizuar qëllimin e prokurimit, që është **“Çmimi më i ulët”**. Alternativën/mundësinë e ka ofruar vet ligji, **“çmime ndërkombëtare të botuara”**.

Grupi i auditimit kërkoi/gjeti çmime ndërkombëtare të botuara dhe rezultoi se vetëm nga 33 pajisje/artikuj që përbëjnë preventivin e projektit “Sistemi multifunksional i kamerave ...” 22 prej tyre janë nga 50% deri në 7 herë më të ulët se sa çmimet e tregut vendas. Nga krahasimi i tyre, diferenca rezulton rreth **189,000 mijë lekë**. Në këtë shumë janë përfshirë vetëm artikujt të cilët kanë çmime të paktën mbi 50 % më të lartë se sa çmimi i preventivit mbi të cilin është llogaritur fondi limit dhe vlerë të konsiderueshme. Të paktën për katër pajisje, krahasimi/ndryshimi i çmimeve është për objekte me karakteristika, specifikime teknike të njëjta. Konkretisht:

	Pajisje	njësi	nr	Çmimi i preventivit	Çmimi ndërkombëtar	Diferenca	Dëmi ekonomik
--	---------	-------	----	---------------------	--------------------	-----------	---------------

1	Kamera multifunkzionale	copë	584	93,150	23,800	69,350	40,500,400
2	UPS Modular 30KVA Smart	cope	16	4,419,500	980,000	3,439,500	55,032,000
3	Kabllo 2x0.5 + 4x0.22	ml	8000	192	36	156	1,248,000
4	Kabllo 2x1 + Skermo	ml	8000	191	40	151	1,208,000
	Shuma						97,988,400

a. Për artikullin me numër rendor 1 “Kamera multifunksionale ...” është marrë në konsideratë çmimi i publikuar nga tregu spanjoll dhe një shumëkombëshe e njohur kineze.

b. Për artikullin me numër rendor 2 “UPS Modular 30 KVA Smart” është marrë në ofertë nga një subjekt vendas i njohur në këtë fushë, sipas së cilës, çmimi është rreth 7000 euro/njësia, ose rreth 980,000 lekë/njësia.

c. Për artikujt me numër rendor 3 dhe 4 janë marrë në konsideratë çmimet e tregut me pakicë, vendas.

Çmimet janë ofruar për blerje me pakicë, për një njësi. Mbështetur në sa më sipër AK në llogaritjen e fondit limit, duhet të operonte duke alternuar çmimet të ndërkombëtare të botuara me OE vendas. Pikërisht kështu ka vepruar BOE fitues. Praktika e gabuar e konstatuar në llogaritjen e fondit limit, nga AK, ka sjellë një efekt negativ të pa rikuperueshëm për Buxhetin e Shtetit.

D. SHPENZIME TË PARASHIKUARA PËR SHËRBIMIN E “MIRËMBAJTJES”, REALIZIMI I TË CILAVE PAS NJË PERIUDHE NJË VJEÇARE (PAS MBARIMIT TË AFATIT TË GARANCISË), PËRBËJNË DËM EKONOMIK PËR INSTITUCIONIN.

AK në preventivin e tenderit me objekt “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit” ka parashikuar edhe zërin “Mirëmbajtje” për pjesën e dytë “Platforma software e menaxhimit” me vlerë të preventivuar rreth 18,000 mijë lekë dhe për pjesën III “Infrastruktura e menaxhimit dhe serverët multifunksional” me vlerë rreth 96,000 mijë për tre vjet, në total 114,000 mijë lekë, ose rreth 38,000 mijë lekë në vit.

Për këtë vlerë AK dhe BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k fitues i tenderit, **nuk kanë paraqitur analizë çmimi/kosto**, të shërbimit të “mirëmbajtjes” së pajisjeve, në kundërshtim me nenin 59/2 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, si dhe kushtin e vendosur nga KZHR sipas të cilit aplikanti (DPSH) duhet të paraqesë “Dokumentet teknike” për projektin:

- Projekti teknik,
- Preventivi, argumentimi teknik,
- Përlllogaritja e kostove të mirëmbajtjes së investimi.

Në DST, në pjesën “Afati i shërbimit “ ndër të tjera është përcaktuar se ... *Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit janë absolute në komponentët e mëposhtëm:*

- Kamera Multifunksionale e Lëvizshme,
- Platforma Software e menaxhimit të video regjistrimeve dhe moduleve multifunksionale,
- Pajisjet e Rrjetit Kompjuterik (pjesa e katërt e preventivit).

BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. fitues, nuk ka mundësi të kryejë sa është kërkuar në DST, në veçanti për “Kamerat Multifunksionale të Lëvizshme dhe “Platforma Software e menaxhimit” të video regjistrimeve dhe moduleve multifunksionale, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tij, nuk ka marrëveshje bashkëpunimi, autorizim prodhuesi, ose/dhe kualifikime/trajnime me subjektin “S.. I..”, nga i cili ka blerë “Kamerat multifunksionale”.

Në tërësi nga dokumentacioni shoqërues, nuk vërtetohet njohja profesionale e punonjësve të BOE fitues, përsa i takon instalimit, konfigurimit dhe mirëmbajtjes së këtyre pajisjeve (përfshirë dhe 4 pajisjet HP për të cilat AK ka kërkuar “Autorizim prodhuesi”), në kundërshtim me KVK e miratuara, sipas të cilave ... *OE duhet të jetë i pajisur me certifikatat/dëshmitë profesionale të këtyre punonjësve të lëshuara nga prodhuesit përkatës...*

Mbështetur në sa më sipër, vlerës së lartë të shërbimit të “mirëmbajtjes”, përhershmerisë së kryerjes së tij, faktit që AK ka në strukturën organike rreth 90 punonjës TI, transferimi i shërbimit të mirëmbajtjes me pagesë, jashtë AK, përbën dëm ekonomik për DPSH.

Për sa më sipër rekomandoj:

Autoriteti kontraktor të marrë masat e nevojshme për llogaritjen/argumentimin e çmimit/kostos së shërbimit të “mirëmbajtjes” për efekt parashikimi të kësaj vlerë në shpenzimet korente vjetore, të cilat Institucioni do t’i kryej me punonjësit e vet. Për të shmangur fenomenin e transferimit të fondeve publike, për shërbimin e “Mirëmbajtjes”, jo vetëm për këtë tender, DPSH të marrë masat e nevojshme për trajnimin në vazhdimësi të stafit të Teknologjisë së Informacionit, qoftë dhe duke rekrutuar punonjës shtesë, me qëllim që kjo strukturë të jetë sa më efiçente, në realizimin e objektivave për të cilat është krijuar, në të kundërt, kryerja e këtyre shpenzimeve do të konsiderohet dëm ekonomik.

Menjëherë

E. MBI PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE

Nga auditimi, rezulton se për vitet 2014 dhe 2015, si dhe 8/mujori i vitit 2016 janë kryer shpenzime për ekzekutime të vendimeve gjyqësore, kryesisht për largime nga puna të punonjësve të Policisë së Shtetit por dhe për detyrime kontraktore, ***gjithsej në 529 raste, në shumën 338,072 mijë lekë*** (nga fondet e çelura për borxhin për 139,009 mijë lekë dhe nga fondet e veta 199,064 mijë lekë), *si detyrime të lindura e të trashëguara para vitit 2014, por dhe gjatë periudhës së auditimit.*

Kryerja e këtyre shpenzimeve, për detyrimin ndaj punonjësve dhe subjekteve të tjera në shumën 338,072 mijë lekë dhe e shpenzimeve përmbarimore në shumën 18,645 mijë lekë, ose gjithsej në shumën 338,072 mijë lekë përbëjnë përdorim pa efektivitet dhe efiçencë të fondeve buxhetore dhe që kanë rënduar padrejtësisht buxhetin e institucionit dhe atë të shtetit, pasi referuar një pjesë të vendimeve gjyqësore, urdhrat për largimet e punonjësve nga puna janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

F. MASA DISIPLINORE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet dhe aktverifikimet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 108/2014 datë 31.7.2014 “Për Policinë e Shtetit”, VKM nr. 786, datë 4.6.2008 për miratimin e “Rregullore e Disiplinës së Policisë” i ndryshuar, në nenin 57, 58, 59 etj, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Policisë së Shtetit të **vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e **masave administrative (dënim me gjobë)**, si dhe marrjen e **masave disiplinore deri në “largim nga detyra”**, në raport me shkeljet e konstatuara, për personat si më poshtë:

1. **A.M** me detyrë ish Shef i Sektorit të Serverëve dhe Aplikimit në cilësinë e kryetarit të grupit të punonjësve të ngritur për hartimin e “termave të referencës” dhe përlllogaritjen e “fondit limit”, njëherësh anëtar i njësisë së prokurimit,

2. **S.R** “ “ “ “ “

3. **D.Gj** specialist në Sektorin e Rrjeteve të Komunikimit anëtar,

4. **F.Sh** punonjës i Drejtorisë së Financës, në zbatim të urdhrin të Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 319, datë 30.4.2015, pasi në tenderin me objekt “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit”:

- **Nuk ka dokumentuar referencat** që kanë shërbyer për llogaritjen e vlerës së plotë të projektit (përfshirë fondin limit), shkaqet e ndryshimit, nga vlera 838,005,339 lekë, deri në vlerën përfundimtare të projektit prej 540,533,139 (nga e cila *fondi limit* 450,444,282 lekë).

Në vijim, në përlllogaritjen e vlerës së plotë të projektit (përfshirë fondin limit) është mbështetur në çmimet e tregut vendas, duke marrë/pranuar oferta nga tre OE vendas. Në vazhdim të kësaj procedure, AK, ka kërkuar oferta ekonomike nga 5 subjekte, tre prej tyre kanë qenë ata që kanë dhënë çmime për llogaritjen e vlerës së plotë të projektit. Në përgjigje të kërkesës së AK, 3 OE kanë kthyer përgjigje, që nuk kanë mundësi të realizojnë këtë projekt, kurse njeri është s’kualifikuar nga AK, pasi nuk plotësonte disa nga kriteret e përcaktuara në DST nga AK. **Realisht tenderi rezulton të jetë kryer mbi bazën e një oferte.**

Sa më sipër, është në **kundërshtim** me nenin 59/2 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ... *Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë si çmimet e tregut, kontrata të mëparshme dhe/ose “çmime ndërkombëtare të botuara”.*

Nga krahasimi i çmimeve sipas tregut vendas të cilat kanë shërbyer për hartimin e preventivit me çmimet e alternuar ndërkombëtarë të botuara dhe vendas, rezulton një rritje e vlerës së preventivit të hedhur në tender rreth **189,000 mijë lekë.**

- **Nuk ka paraqitur analizë çmimi/kosto**, të shërbimit të “mirëmbajtjes” së pajisjeve, në kundërshtim me nenin 59/2 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, si dhe kushtin e vendosur nga KZHR sipas të cilit aplikanti (DPSH) duhet të paraqesë “Dokumentet teknike” për projektin:

- *Projekti teknik,*
- *Preventivi, argumentimi teknik,*
- *Përlllogaritja e kostove të mirëmbajtjes së investimi.*

Në preventivin e tenderit me objekt “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit” ka parashikuar edhe zërin “Mirëmbajtje” për pjesën e dytë “Platforma software e menaxhimit” me vlerë të preventivuar rreth 18,000 mijë lekë dhe për pjesën III “Infrastruktura e menaxhimit dhe serverët multifunksional” me vlerë rreth 96,000 mijë për tre vjet, në total 114,000 mijë lekë, ose rreth 38,000 mijë lekë në vit.

- Nuk ka bërë **ndryshimet e kërkuara** nga AKSHI, në projektin teknik sipas dokumenteve standard për projektet teknike në fushën e TIK.

AKSHI me shkresë nr. 1516/1, datë 18.8.2015, është shprehur se ... *parimisht bie dakord në lidhje me specifikimet teknike të projektit ... me kusht që të reflektoni në dokument sugjerimet e mëposhtme...* Në vijim jepen 25 sugjerime ndër të cilat me numër 25 është sugjerimi me përmbajtje si vijon ... *Për UPS 30 KVA, të përgjithësohen specifikimet teknike pasi të çojnë*

në një produkt APC dhe të jepen specifikime minimumi për tre produkte (Në përfundim të procedurës rezulton të jetë blerë UPS, produkt i APC me fond limit rreth 71,000 mijë lekë).

- **Nuk ka përcaktuar, ose ka përcaktuar gabim shërbimin e “Mirëmbajtjes”** nga kompania fituese, pasi është shprehur se ... *Gjatë periudhës së mirëmbajtjes kompania fituese duhet të ketë mjaftueshëm pajisje rezerve ... Maksimumi i pajisjeve për zëvendësim 3 për qind të totalit të pajisjeve në përdorim.*

I formuluar kështu, duke filluar nga “zero”, ky “kriter” nuk përbën asnjë detyrim për OE fitues. Risku është se në rast defekti të pajisjeve, rriten shpenzimet e mirëmbajtjes nga AK. Njësia e prokurimit, nuk është shprehur minimalisht se cilët janë pajisjet prioritare që duhet të mbulojnë mirëmbajtjen në rast defekti.

- **Nuk është shprehur (ka përjashtuar) në DST:**

Paraqitjen/pajisjen me “Autorizim prodhuesi” të OE pjesëmarrës, të përzgjedhur në tender, për pajisjet e tjera, në veçanti të disa prej tyre si “Kamerat multifunkionale ...”, “UPS smart” dhe Switch core L/2L/3, të cilat përfaqësojnë rreth 44 për qind të fondit limit të 33 prej artikujve/pjesëve të kërkuara.

Garancinë për këta artikuj (ka kërkuar garanci vetëm për 4 artikuj nga rreth 33 gjithsej).

Në kapitullin “mirëmbajtja” të “Specifikime teknike” të DST, ndër të tjera është përcaktuar se ... *Komponentët kryesorë të sistemit janë:*

- *Kamera Multifunkionale e Lëvizshme,*
- *Platforma Software e menaxhimit të video regjistrimeve dhe moduleve multifunkionale,*
- *Pajisjet e Rrjetit Kompjuterik.*

Gjatë realizimit të këtij shërbimi, kompania fituese do të jetë përgjegjëse për Kamerat Multifunkionale të Lëvizshme.

Në pjesën “Afati i shërbimit “ ndër të tjera është përcaktuar se ... *Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit janë absolute në komponentët e mëposhtëm:*

- *Kamera Multifunkionale e Lëvizshme (pjesa parë e preventivit),*
- *Platforma Software e menaxhimit të video regjistrimeve dhe moduleve multifunkionale, (pjesa e dytë e preventivit)*
- *Pajisjet e Rrjetit Kompjuterik, (pjesa e katërt e preventivit).*

Në veçanti, mungesa, mos parashikimi në DST i “Autorizim prodhuesi”, “garancisë” dhe “mirëmbajtjes” për “Kamera Multifunkionale e Lëvizshme”, do të shoqërohet me shpenzime shtesë për zëvendësimin e kamerave në rast difektesh apo dëmtimesh, pasi softëare i kamerës është i identifikuar me IMEI dhe në këto kushte kamera del jashtë pune së bashku me softëare.

- Nuk ka kërkuar punonjës të certifikuar (nga furnizuesi/prodhuesi) për platformën Software të ofruar (ka kërkuar vetëm për pajisjet ... *Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka stafin e nevojshëm teknik prej minimalisht 5 (pesë) punonjësish të certifikuar nga prodhuesit për suportin e pajisjeve të infrastrukturës (Server, Storage, Switch dhe Workstation) që ofron.*

Megjithëse është evidentuar fort rëndësia e tyre, njësia e prokurimit, nuk ka kërkuar Autorizim prodhuesi (certifikatë origjine, garanci) për tre nga pjesët përbërëse të sistemit, por ka kërkuar vetëm për katër pajisje për pjesën e III “Infrastruktura e menaxhimit ...”.

- Nuk ka miratuar dokumentacionin mbi studimin e tregut dhe argumentimin e fondit limit për prokurim, ndërkohë që ky propozim për llogaritjen e fondit limit është marrë në konsideratë në procedurën vijuese të tenderit **në kundërshtim me** urdhrin e DPSH nr. 319, datë 30.4.2015.

5. E.D me detyrë Drejtor i Drejtorisë TI, në cilësinë e kryetarit të KVO,

6. E.K,

7. S.H, me detyrë Specialist në Sektorin e Rrjetave dhe të Komunikimeve, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, pasi në tenderin me objekt “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit” ka kualifikuar e në vijim të procedurës ka shpallur fitues BOE “C..” sh.p.k. & “T..” shpk me parregullsitë, mangësitë si më poshtë:

- Në DST, në pjesën “Afati i shërbimit “ ndër të tjera është përcaktuar se ... *Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit janë absolute në komponentët e mëposhtëm:*

- *Kamera Multifunksionale e Lëvizshme,*
- *Platforma Softëare e menaxhimit të video regjistrimeve dhe moduleve multifunksionale,*
- *Pajisjet e Rrjetit Kompjuterik (pjesa e katërt e preventivit).*

- BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. fitues, nuk ka mundësi të kryejë sa është kërkuar në DST, në veçanti për “Kamerat Multifunksionale të Lëvizshme dhe “Platforma Software e menaxhimit” të video regjistrimeve dhe moduleve multifunksionale, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tij, nuk ka marrëveshje bashkëpunimi, autorizim prodhuesi, ose/dhe kualifikime/trajtime me subjektin “S.. I..”, nga i cili ka blerë “kamerat multifunksionale”.

Në tërësi nga dokumentacioni shoqërues, nuk vërtetohet njohja profesionale e punonjësve të BOE fitues, përsa i takon instalimit, konfigurimit dhe mirëmbajtjes së këtyre pajisjeve (përfshirë dhe 4 pajisjet HP për të cilat AK ka kërkuar “Autorizim prodhuesi”), në kundërshtim me KVK e miratuara, sipas të cilave ... *OE duhet të jetë i pajisur me certifikatat/dëshmitë profesionale të këtyre punonjësve të lëshuara nga prodhuesit përkatës... Shërbimi i “mirëmbajtjes” është parashikuar rreth 18,000 mijë lekë për pjesën e II dhe për pjesën III “Infrastruktura e menaxhimit dhe serverët multifunksional” të preventivit, me vlerë rreth 96,000 mijë për tre vjet, në total 114,000 mijë lekë, ose rreth 38,000 mijë lekë në vit.*

Këtu përfshihen dhe 4 pajisjet HP për të cilat AK ka kërkuar “Autorizim prodhuesi” (AP), pasi AP i paraqitur nga BOE, nuk i parashikon (nuk ka pranuar bashkëpunimin me BOE për këtë tender) asnjë detyrim ndaj BOE fitues.

- BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. ka paraqitur furnizime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare, në një vlerë prej 72,600 mijë lekë, ose rreth 16 për qind të vlerës së fondit që prokurohet prej 450,012 mijë lekë, **në kundërshtim me** pikën 2.3 “kapaciteti teknik” I KVK në të cilën është përcaktuar se ... *Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë furnizime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare, në një vlerë prej 40 për qind, ose 180,004 mijë lekë, e vlerës së fondit që prokurohet.*

BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. ka paraqitur furnizime të mëparshme, të ngjashme një kontratë të realizuar gjatë vitit 2014 me subjektin “I.. grup” me vlerë 72,600 mijë lekë të kryer nga OE “T..” sh.p.k.

OE “C..” sh.p.k. nuk ka paraqitur punime të mëparshme të ngjashme, në kundërshtim me neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në të cilin është përcaktuar se ... *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat*

ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

- “Autorizim prodhuesi” (AP) i paraqitur nga BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. nuk është i rregullti, i kërkuari nga AK, pasi nuk përshkruan në mënyrë specifike që Operatori Ekonomik është i Autorizuar nga Prodhuesi për të ofruar produktet e kërkuara, **në kundërshtim** me sa është parashikuar në KVK të DST, në të cilat është përcaktuar se ... *Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi (MAF) për pajisjet e infrastrukturës (Server, Storage, Switch dhe Workstaion) ku të përshkruhet në mënyrë specifike që Operatori Ekonomik është i Autorizuar nga Prodhuesi për të ofruar produktet e kërkuara.*

(Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzimit, të “Sistemi multifunksional i kamerave ..”, rezultoi se pajisjet e infrastrukturës (Server, Storage, Switch dhe Workstaion) nuk janë të shoqëruara me certifikatë origjinale (autorizim prodhuesi), **në kundërshtim** me sa është përcaktuar në KVK e miratuara më DST nga AK).

Nëpërmjet personit përgjegjës të autoritetit kontraktor, ju kërkua BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. që në prezencë të tij, **të paraqiste në origjinal “autorizim prodhuesi” (AP)**, e cila normalisht duhet të ishte pjesë e dokumentacionit të dosjes, pasi është e dedikuar për DPSH, dhe certifikatat origjinale të kualifikimeve, të personave që do të realizonin projektin, por **BOE, nuk i paraqiti**. Në dosje ato gjendeshin, të noteruara. Sipas dokumentacionit shoqërues, tërësisht pajisjet/artikujt janë kryesisht me origjinë kineze, si dhe Tajvan, Filipine, Çeki, Itali etj.

- BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. nuk ka deklaruar “drejtues projekti”, të pajisur me certifikimet përkatëse ndërkombëtare për ndjekjen/realizimin e projektit, në **kundërshtim** me pikën 2.3. të KVK të miratuara me DST, në të cilën është përcaktuar se ... *OE ofertues duhet të deklarojë një drejtues projekti, i cili do të shërbejë si pikë e vetme kontakti për të gjithë periudhën e kohë zgjatjes së kontratës (të paktën nuk ka trajnime/certifikime nga OE “S I” për “kamerat multifunksionale” dhe “Platforma Software e menaxhimit” të video regjistrimeve dhe moduleve multifunksionale” nga i cili i ka blerë etj).*

- Në kontratën “Për bashkimin e përkohshëm të shoqërive” **nuk janë përcaktuar** dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, në kundërshtim me neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në të cilin është përcaktuar se ... Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen ... *përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.*

- Oferta e paraqitur nga BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. nuk është e lidhur dhe e numerizuar në **kundërshtim** me pikën 1.3 të DST në të cilën është përcaktuar se ... *Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkreore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen.*

- Mbështetur në pikën 1.1. të DST e cila përcakton se ... *Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme, AK duhet të refuzonte ofertën.*

- Pasi është shpallur fitues BOE “C..” sh.p.k. & “T...” sh.p.k. në tenderin me objekt “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit ...” gjatë procesit të negociimit, ka pranuar/ndryshuar *zërat me numër 13 dhe 14 të paragrafit IV “Rrjeti i komunikimit aktiv”* duke negociuar për sasi të/volumet në ulje, dhe çmimet në rritje. Praktika normale pranon si objekt të negociimit uljen e çmimit të sasive/volumeve të preventivuara dhe jo ulja e sasive të parashikuara në preventiv, pasi sasi të/volumet janë të pa negociueshme. Sasi të apo volumet e mallrave janë hartuar/miratur nga grupet përkatëse dhe janë pjesë e DST, të hedhur në tender me të cilat OE janë njohur, i kanë pranuar dhe kanë paraqitur ofertën përkatëse.

Po kështu, pas përcaktimit të ofertës/operatorit ekonomik fitues, objekt negociimi, nuk është rritja e çmimit, por ulja e tij. Në këto kushte vlerësojmë që KVO ë vepruar në kundërshtim me nenin 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.* Sasi të e ndryshuara në ulje, cilat nuk janë reflektuar në fondin limit, janë 10,400 ml kablllo të llojeve të ndryshme me vlerë 1,990,000 lekë gjithsej.

Me parregullsitë e evidentuara në dokumentacioni ligjor kualifikues, KVO duhet të kishte skualifikuar BOE “C..” sh.p.k. & “T...” sh.p.k.

Për parregullsi, mangësi të tjera të konstatuara lidhur me dorëzimin/pranimin e pajisjeve të bëra hyrje në DPSH, nga Komisioni i marrjes në dorëzim i AK.

8. B.Z,

9. J.R,

10. L.D,

11. G.B me detyrë specialistë në Drejtorinë e TI, në cilësinë e personave që kanë pranuar/marrë në dorëzim pajisjet e sjella nga BOE “C..” sh.p.k. & “T...” sh.p.k. për efekt të zbatimit të kontratës për tenderin me objekt “Sistemi multifunksional i kamerave...”, pasi:

- Katër pajisjet/artikujt e furnizuar, nuk janë të pajisura me certifikatë origjine dhe garanci nga prodhuesi (në zbatim të “autorizim prodhuesi”) në kundërshtim me sa është përcaktuar në KVK e DST të miratuara.

BOE “C..” sh.p.k. & “T...” sh.p.k. si certifikatë origjine (autorizim prodhuesi) për katër pajisjet/artikujt e furnizuar që ka kërkuar/përcaktuar AK ka paraqitur:

- *Workstation HP Z440...* “Deliveri note” (faturë shitje) për artikuj të ndryshëm në të cilat përfshihet dhe Workstation HP Z440, 10 faqe, të cilat C.. sh.p.k. i ka blerë nga Çekia. Në krye të faturës është shënuar HP Geneva Sëitserland, kurse në fund është shënimi: vendi origjinës Republika Çeke. “Fletët” janë pa vulë, pa firmë dhe jo të dedikuara “Për Drejtorinë e Policisë së Shtetit, si është përcaktuar në KVK.

- *Switch core L2/L3 – HP 5500 ...* “Deliveri note” (faturë shitje) për artikuj të ndryshëm në të cilat përfshihet dhe *Switch core L2/L3 – HP 5500*, 7 faqe.

Blerës është subjekti ITD sh.p.k. (subjekt vendas). Në këtë rast, BOE “C..” sh.p.k. & “T...” sh.p.k. jo vetëm nuk ka lidhje me prodhuesin, por duke pasur në konsideratë që procedura e prokurimit është e klasifikuar “sekret”, ka vepruar në kundërshtim me marrëveshjen lidhur midis AK dhe BOE për ruajtjen e “sekretit...” në zbatim të VKM nr. 701, datë 22.10.2014

“Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”.

- *Blade server HP 460 ... “Deliveri note” (faturë shitje) për artikuj të ndryshëm në të cilat përfshihet dhe Switch core L2/L3 – HP 5500, 15 faqe, me pajisje/artikuj nga vende të ndryshme si Çeki, Kinë etj.*

Blerës është përsëri subjekti ITD sh.p.k. BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. jo vetëm nuk ka lidhje me prodhuesin, por duke pasur në konsideratë që procedura e prokurimit është e klasifikuar “sekret”, ka vepruar në kundërshtim me marrëveshjen lidhur midis AK dhe BOE për ruajtjen e “sekretit...” në zbatim të VKM nr.701, datë 22.10.2014 *“Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”.*

- *Storage ... E njëjtë si më lart.*

Veç sa më sipër, pajisje të tjera, kryesisht, nga pjesa e katërt e preventivit të “Sistemit multifunksional...” janë furnizuar direkt nga subjekti vendas “I...” për Policinë e Shtetit, në kundërshtim me sa parashikon kjo procedurë e klasifikuar “sekret...” në zbatim të VKM nr. 701, datë 22.10.2014 *“Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”.*

Lidhur me *UPS Modular 30KVA Smart, artikulli me nr III/16 I preventivit, BOE ka paraqitur si certifikatë origjinë (Autorizim prodhuesi) një “Listë” pa emër, pa firmë, pa vulë, pa lidhje me BOE “C..” sh.p.k. & “T..”sh.p.k., të shkarkuar nga interneti me lloje të ndryshme UPS me origjinë Filipine, që daton shtator viti 2009.*

Në vijim të dokumentacionit dorëzues, gjenden dy fletë me emërtim “packing list” për UPS smart, me dërgues “Sh e B, për blerësin subjekti DAP Tiranë, datë 25.11.2015, pa vulë dhe firmë, e cila, nuk rezulton të ketë lidhje me BOE “C..” sh.p.k. & “T..” sh.p.k. fitues. Në dosje, nuk ka dokumentacion/ faturë që të vërtetojë se blerja është kryer.

- Përgjithësisht pajisjet/artikujt e furnizuar, nga verifikimi i dokumentacionit shoqëruar nuk janë të certifikuar nga Komuniteti Evropian, **në kundërshtim me “specifikimet teknike”** shtojca 10 e DST të miratuara nga AK, në të cilën është përcaktuar ndër të tjera *... pajisjet të jenë të certifikuar nga Komuniteti Evropian...*

- Në përfundim të procedurës së tenderit u konstatua se BOE fitues, nuk ka paraqitur garanci (certifikatë origjinë) për asnjë artikull. Në vend të tyre ka ofruar garancinë e tij si OE, ndërkohë, që vetëm në një rast (kamera multifunksionale) pajisja është shoqëruar me certifikatë origjinë (por jo garanci pajisje). Në përgjithësi dokumentacioni shoqëruar për pajisjet që ë paraqitur BOE fitues, nuk tregon se si ka ardhur pajisja, nga kush subjekt, vend etj, duke venë në dyshim vërtetësinë e pajisjeve të paraqitura.

Me parregullsitë e evidentuara në dokumentacionin shoqëruar të pajisjeve të sjella, në DPSH, grupi i marrjes në dorëzim, nuk duhet të pranonte marrjen në dorëzim të tyre.

12. I. N, me detyrë Shef i Sektorit të Prokurimeve në cilësinë e kryetarit/anëtarit të KVO, pasi në procedurën e tenderit me objekt:

- *“Uniforma për Policinë e Shtetit” me vlerë 198,000 mijë lekë, i zhvilluar në vitin 2015.* Procedura e zgjedhur/zhvilluar ka qenë *“Me negociim pa shpallje ...” “shtesë kontrate”* bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Baza ligjore së cilës i është referuar AK, nuk qëndron. AK, nuk gjendet në asnjë nga parashikimet e përcaktuara në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Normalisht AK duhet të zhvillonte procedurë “Të hapur”.

- “Blerje qese dhe arka për administrimin e provave” i zhvilluar në vitin 2015.

Procedura e zgjedhur/zhvilluar ka qenë “Me negociim pa shpallje ...” bazuar në nenin 33 pika 2/b e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 36 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shkresën e Departamentit të Krimit të Organizuar 3.996, datë 29.7.2015 dhe nr. 3696/1, datë 21.9.2015 me objekt “Sigurimin e qeseve të provave...” etj...

Baza ligjore së cilës i është referuar AK, nuk qëndron. AK, nuk gjendet në asnjë nga parashikimet e përcaktuara në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Normalisht AK duhet të zhvillonte procedurë “Të hapur”.

- “Studim projektim i objekteve të Policisë së Shtetit” i zhvilluar në vitin 2016, në të cilin është shpallur fitues, OE “C..” sh.p.k. ka pranuar në preventivin/situacionin e paraqitur prej tij, përsëritje të zërave/punëve të kryera me vlerë rreth 16,500,000 lekë (e njëjta punë e paguar dy herë), e cila përbën dëm ekonomik për AK.

13. D.C, me detyrë specialist në Sektorit e Prokurimeve, me profesion jurist, pasi kanë gabuar në përcaktimin, zgjedhjen e procedurës së tenderit me objekt “Uniforma për Policinë e Shtetit” me vlerë 198,000 mijë lekë, i zhvilluar në vitin 2015.

Procedura e zgjedhur/zhvilluar ka qenë “Me negociim pa shpallje ...” “*shtesë kontrate*” bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Baza ligjore së cilës i është referuar AK, nuk qëndron. AK, nuk gjendet në asnjë nga parashikimet e përcaktuara në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Normalisht AK duhet të zhvillonte procedurë “Të hapur”.

14. S.D në cilësinë e kryetarit,

15. K.K,

16. A.A,

17. A.L në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Pritjes dhe Kolaudimit të mallrave”, në zbatim të kontratës lidhur midis palëve në vitin 2015 për blerje “Dyshekë alpinë dhe çanta shpine taktike” pasi:

Mallrat e furnizuar nga OE “Gj..” sh.p.k. dhe të pranuar/magazinuara në D P SH, nuk janë në zbatim nenit 6 “Kushtet e lëvrimit” të kontratës nr. 37/4, datë 17.11.2015 lidhur midis autoritetit kontraktor dhe OE “Gj..” sh.p.k. të vendosura në mbështetje të germës “b” dhe “c” të pikës 2.3 “kapaciteti teknik” të KVK të kërkuara nga AK.

Nga verifikimi i mallrave të furnizuara nga OE “Gj..” sh.p.k. të pranuar/magazinuara nga DPSH dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, u konstatua se:

- Sipas certifikatës së origjinës që i shoqëron, mallrat kanë ardhur nga Kina, në kundërshtim me pikën 2.3 të KVK të kërkuara nga AK, në zbatim të së cilës mallrat duhet të kishin origjinë nga Turqia (“Autorizim prodhuesi” është lëshuar nga subjekti “Ç..”, Turqi), në të cilin ndër të tjera, është shprehur se ...*Nëpërmjet këtij dokumenti japim garanci të plotë për*

mallrat që ju prezantohen nga ana e “Gj..” sh.p.k. përsa i përket sigurimit dhe dorëzimit në përputhje me Kushtet e Kontratës së Përgjithshme).

- Laboratori i Akredituar i Universitetit Politeknik i Tiranës, në analizën e lëshuar (e përsëritur me kërkesë të AK), nuk është shprehur për karakteristikat e matshme në specifikimet teknike të kërkuara/përcaktuara lidhur me artikullin “çantë shpine” nëse materiali përbërës është i papërshkueshëm nga uji, për të dy artikujt, dhe për artikullin “Dyshek me dy shtresa”, nëse materiali përbërës realizon “mbrojtjen në temperatura - 20 gradë”.

H. TË TJERA

Departamenti i Performancës në bashkëpunim me Departamentin Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës në KLSH, të iniciojë punën për planifikimin dhe zhvillimin sa më parë të një auditimi tematik performance në drejtim të trajtimit financiar të punonjësve të policisë.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Raporti Përfundimtar i Auditimit do të përcillet subjektit të audituar brenda 10 ditëshit të parë të muajit Janar të vitit 2017, pas përgatitjes së kallëzimit përkatës penal nga Drejtoria Juridike, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

K R Y E T A R

Bujar LESKAJ